



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Statistikor Bankar

Udhëzimet për raportim

V e r s i o n i 2 . 0



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **RAPORTI STATISTIKOR BANKAR**

UDHËZIMET PËR RAPORTIM

**(Versioni 2.0)**

**BOTUES**

©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Rr.Garibaldi 33, Prishtina 10 000  
Tel: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Posta elektronike**

[statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org)

## PËRMBAJTJA

<b>1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME</b>	<b>5</b>
1.1. Hyrje	5
1.2. Frekuenca dhe mbulueshmëria	5
1.3. Format dhe afatet	5
1.4. Udhëzime teknike	6
<b>2. FORMULARËT DHE UDHËZIMET E DETAJUARA</b>	<b>7</b>
2.1. Bilanci i gjendjes	7
2.2. Kreditë sipas aktivitetit ekonomik	17
2.3. Përbërja e portofolios së letrave me vlerë	18
2.4. Kreditë sipas afateve	19
2.5. Depozitat sipas afateve	19
2.6. Borxhi i emetuar nga bankat	20
<b>3. RREGULLAT E VALIDIMIT</b>	<b>21</b>
<b>4. FORMULARËT E RAPORTIMIT</b>	<b>21</b>
<b>5. SHTOJCAT</b>	<b>31</b>



## 1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

### 1.1. Hyrja

Objektivat parësore të BQK-së janë nxitja e qëndrueshmërisë, aftësisë pagueuese dhe funksionimi efikas i sistemit financiar, si dhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike me qëllim për të kontribuar në shperndarjen efikase të burimeve. Në përputhje me rregullën XI të BQK-së (Raportimi i bankave dhe të degëve të bankave të huaja të Kosovës), BQK-ja përpilon statistikën monetare dhe financiare, si dhe statistikën e sektorit të jashtëm.

Në përputhje me këtë, BQK-ja zbaton Raportin Statistikor Bankar (RSB-en) për të marrë informacion mbi gjendjen financiare të bankave. Hartimi i RSB-së është i bazuar në standardet ndërkombëtare, të tilla si Manuali për Statistikat Monetare dhe Financiare (MSMF 2000), Udhëzuesin për Hartimin e Statistikave Monetare dhe Financiare (MFSG 2008), Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 95), Sistemi i Llogarive Kombëtare (SNA 93), dhe praktika të vendeve të tjera.

### 1.2. Frekuenca dhe mbulueshmëria

RSB-ja duhet të raportohet në baza mujore, duke përshkruar gjendjen financiare të bankës në ditën e fundit të punës së muajit. E shtuna do të konsiderohet si një ditë pune. RSB-ja do të përmbajë vetëm pozitën e njësive bankare që ndodhen në Kosovë. RSB-ja raportohet në bazë bruto kështu që as netimi (aplikimi i parimit neto) as kompensimi nuk lejohet, me përjashtim të kërkesave reciproke ose obligimeve ndërmjet njësive që i përkasin bankës raportuese në RSB-në në fjalë.

### 1.3. Format dhe afatet

RSB-ja do të dorëzohet në formë të shtypur dhe në formë elektronike. Dorëzimi duhet të përmbajë të gjitha afatet e nevojshme për një periudhë të raportimit dhe duhet të jetë plotësisht në përputhje me Udhëzimet e Raportimit të përcaktuara në këtë dokument. Fillimisht, vetëm një kopje elektronike e RSB-së duhet të dorëzohet me e-mail në Drejtorinë e Statistikës të BQK-së. Pasi kontrollimi të ketë përfunduar me sukses, statisticioni duhet të konfirmojë me e-mail ose telefon dhe të kërkojë formën në letër (të shtypur) të RSB-së nga banka përkatëse. Forma e shtypur e këtij raporti duhet të dorëzohet në:

Drejtoria e Statistikës  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Rr. Garibaldi 33, Prishtinë, 10000  
Republika e Kosovës

jo më vonë se 15 ditë kalendarike pas skadimit të muajit referues.

Dërgesa duhet të përmbajë faqen e parë të RSB-së të nënshkruar nga personat e autorizuar dhe të vulosur nga banka përkatëse.

Para se RSB të dërgohet në BQK, të dhënat duhet të reflektojnë pozicionin e duhur financiar dhe shumat e deklaruara në RSB, dhe duhet të rikontrullohen nga raportuesi, d.m.th shumat zëravepërkatës duhet të jenë të njëjtat me shumat të shprehura po për këta zëra në RSB.

Rregullat e vlefshmërisë (validimit), të paraqitur në Shtojcën 1 të këtyre Udhëzimeve Raportuese, do të udhëzojnë raportuesit për të përmbushur këto kushte. Gabimet që bien ndesh nga ky udhëzim do t'i komunikohen bankës raportuese duke nënkuptuar ridërgimin e raportit. Në rast të mospërputhjeve ose ndryshimi në krahasim me raportin e mëparshëm, RSB-së, së dorëzuar duhet t'i bashkëngjitet një shpjegim i shkurtër. Bankat duhet të ruajnë evidencën e të dhënave të raportuara në RSB. Nëse BQK-ja zbulon gabime serioze në RSB, ajo mund të kërkojë korrigjimet e nevojshme apo sqarimin e të dhënave.

Pyetjet lidhur me RSB dhe interpretimet e çdo pjese të këtyre Udhëzimeve Raportuese duhet t'i drejtohen BQK-së. Shpjegime dhe interpretime të tilla janë veçanërisht të dobishme në rastin e aktiviteteve të biznesit, të cilat nuk janë përshkruar posaçërisht në këto Udhëzime të Raportimit. Nëse interpretimi i BQK-së mbi këto udhëzime ndryshon nga ai i bankave komerciale, BQK-ja mund të kërkojë nga banka të përgatitë RSB-në e saj në përputhje me interpretimin e BQK-së dhe të ndryshojë raportet e mëparshme.

#### 1.4. Udhëzimet teknike

Të gjitha shumat duhet të raportohen në mijëra euro rrumbullakësuar/përafëruar në shifrën më të afërt (p.sh. zërat që janë më poshtë 500 € do të raportohen si zero). Edhe nëse të gjitha të dhënat në RSB janë të shprehura në euro, raportimi mund të ndryshojë sipas formularit. Tri raste janë të mundshme dhe duhet të përmenden në pjesën e sipërme të formave të raportimit. Formularët u referohen shumave të akumuluar (papaguara) në:

- Vetëm në euro;
- Vetëm në valuta të tjera përveç euro, por të konvertuara në euro për qëllime të raportimit;
- Euro e kombinuar me monedha të tjera përveç euro, por të konvertuara në euro për qëllime të raportimit;
- Diferencat e rrumbullakësuar/përafëruar—shuma e komponentëve nuk jep domosdoshmërisht totalin e saktë të shumës së raportuar.

Asnjë zë në RSB nuk mund të lihet bosh. Duhet të bëhet një hyrje për çdo zë, dmth një shumë (p.sh. një zero). Të gjitha shënimet negative duhet të paraprihen nga shenja minus (-). Shumat në monedha të tjera përveç euro duhet të konvertohen në monedhën euro duke zbatuar kursin e këmbimit të BQK-së, dhe t'i dërgohen bankës në ditën e fundit kalendarike të periudhës së caktuar, vetëm për qëllime të raportimit të RSB. Për monedhat që nuk janë në atë listë, kursi i këmbimit duhet të merret nga banka raportuese duke iu referuar normave që mbizotërojnë në ditën e fundit të punës së bankës për muajin referues.

Ndarja e aseteve dhe detyrimeve, do të bëhet në bazë të monedhës me të cilën është emërtuar zëri i asetit apo detyrimit. Asetet dhe detyrimet në ar të negociueshme duhet të regjistrohen si në monedhë të huaj. Pasuria e paluajtshme shprehet në monedhën e vendit në të cilin prona është vendosur. Nëse nuk caktohet ndryshe, ndarja e aseteve dhe detyrimeve sipas maturitetit duhet të bazohet në kohëzgjatjen e maturimit origjinal të aseteve apo detyrimeve në fjalë. Ata mbeten brenda asaj kategorie pa marrë parasysh maturimin e mbetur. Ndarja gjeografike e aseteve/detyrimeve është bazuar në



vendbanimin (rezidencës) kryesor të debitorit/ kreditorit. Në rastin e kompanive (korporatave financiare dhe jofinanciare) kjo do të thotë zyra e regjistruar.

Ndarja sipas sektorëve institucionalë është paraqitur në shtojcën 2 (sektorët institucional). Tabela e detajuar jep një pasqyrë dhe një sërë detajesh për ndarje sipas sektorëve institucionalë.

## 2. FORMULARËT DHE UDHËZIMET E DETAJUARA

### 2.1. Bilanci i gjendjes (*Formulari i BGJ*)

#### A. Udhëzime të përgjithshme

Formulari BGJ raporton asetet dhe detyrimet dhe përbën pjesën kryesore të RSB-së të cilit i referohen shumica e tabelave të tjera. Bilanci i gjendjes së RSB-së përmban shtatë kolona. Kolona e parë përmban të gjitha asetet apo detyrimet të shprehura në euro apo ekuivalente të euros. Shumat në kolonën e parë janë të ndara në asete apo detyrime në euro (kolona e dytë) dhe asetet apo detyrimet të shprehura në valutë jo-euro (kolona e tretë). Shumat në kolonën e dytë ndahen më tej në dy kolona (kolona e katërt dhe e pestë), në bazë të rezidencës (në vend ose jashtë vendit) të homologëve. Në të njëjtën mënyrë, shumat në kolonën e tretë ndahen në dy kolona (kolona e gjashtë dhe e shtatë).

#### B. Udhëzim të detajuara sipas rreshtave

#### ASETET

##### 119. Paraja dhe bilanci me BQK-në

##### 112. Paraja

Paraja përbëhet nga kartëmonedhat dhe monedhat që kanë një vlerë nominale fikse dhe janë lëshuar zakonisht nga bankat qendrore. Paraja (valuta) ndahet në kategori të veçanta për monedhën kombëtare dhe valutën e huaj dhe përbëhet nga *paratë e gatshme*, *çeqet dhe dëftesa (forma) të tjera të pagesave*. *Paratë e gatshme* përfaqësojnë shumën e kartëmonedhave dhe monedhave në euro dhe valuta të tjera, me kusht që ato janë ligjërish të lejuara në Kosovë ose në vendin e tyre të emetimit. Ato përfshijnë gjithashtu fonde të mbajtur me delegim në lidhje me aktivitetet e tyre si agjentë (përfaqësuesit) e bankës raportuese. *Çeku dhe dëftesat e tjera të pagesave* përfaqësojnë shumën e çeqeve dhe instrumenteve tjera të pagesës që janë në thesar ose në përdorim. Secili nga këto instrumente duhet të jetë i pagueshëm menjëherë sapo të prezantohet dhe të tërhiqet nga ndonjë tjetër institucion financiar.

## **115. Bilancet me BQK-në**

### **115-1. Rezervat dhe llogaria rrjedhëse në BQK-në**

Ky pozicion mbulon rezervat e detyrueshme të mbajtur në BQK-në. Të gjitha aktivat e paguara në para në llogaritë e bankave të alokuara në BQK duhet të raportohen në këtë pozicion. Përveç kësaj, të gjitha gjendjet e llogarive rrjedhëse duhet të raportohen (p.sh. asete në para të mbajtura në llogarinë e hapjes së bankës me BQK-në).

### **115-3. Depozita të tjera në BQK**

Kjo kategori përfshin shumën totale të të gjitha depozitave të tjera të mbajtura në BQK, përveç rezervave dhe llogarive rrjedhëse.

### **129. Bilancet me bankat komerciale**

Ky zë përfshin kërkesat e bankave komerciale. Ato nuk përfshijnë letrat me vlerë të transferueshme (ato raportohen në zërin 139) as kërkesat që janë pjesë e aseteve fikse (ato raportohen në zërin 179).

### **121. Llogaritë rrjedhëse**

Ky zë paraqet gjendjet menjëherë të arkëtueshme të llogarive rrjedhëse të bankës raportuese me bankat komerciale. Këto përfshijnë kërkesat, të garantuara ose jo, që rezultojnë nga kredi me afat të caktuar apo me mundësi rinovimi deri në një ditë pune ose me një periudhë të njoftimit për një ditë pune.

### **125. Depozitat me afat ( kohore)**

Ky zë, regjistron të gjitha llojet e tjera të kërkesave ndërbankare (përveç llogarive rrjedhëse) që rezultojnë nga aktivitetet e rregullta me bankat komerciale. Ky zë përmban kërkesat me një afat të caktuar më shumë se një ditë pune ose për një periudhë të caktuar më shumë se një ditë pune dhe kërkesat që rrjedhin nga mobilizime dhe avancet (rizbritjen e faturave të tregtisë, marrëveshjet e riblerjes, avancet me ose pa hipotekë, mbiterheqjet në llogaritë rrjedhëse).

### **128. Plasmane të tjera**

Kjo kategori përfshin të gjitha aktivitetet ndërbankare që nuk janë përfshirë përveç llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat. Kjo kategori përfshin kreditë ndërbankare, linjat e kredisë dhe të ngjashme. Megjithatë ky zë nuk duhet të përfshijë asnjë lloj të letrave me vlerë. Ky zë është homolog me artikullin 215 Huamarrje të tjera.

### 139. Letrat me vlerë

Ky zë mbulon instrumentet e negociueshme, pa marrë parasysh maturimin e instrumentit dhe ndahen në letra me vlerë investuese apo tregtare.

### **132. Portofolio Investuese**

Ky zë mbulon instrumentet e negociueshme, afatshkurtra dhe afatgjata, kur ato përftohen nga institucioni raportues për konsideratë të fitimit dhe parimisht mbahen deri në maturim. Këto instrumente mund të blihen në tregun primar ose në tregun sekondar. Instrumentet e negociueshme që konsiderohen si pjesë e aseteve fikse janë përjashtuar nga ky zë dhe raportohen në pikën 171. Të gjitha llojet e letrave me vlerë përmblihen nën këtë pikë: aksionet, letrat me vlerë me afat të shkurtër (p.sh. letër komerciale, bonot e thesarit të lëshuar nga qeveria, institucionet financiare, institucionet jofinanciare dhe pjesa tjetër e botës), letra me vlerë afatgjate (p.sh. obligacione), etj .

Sipas marrëveshjes, letrat me vlerë që duhet të dorëzohen, kur një bankë është pjesë e një paneli-emetues regjistruhen edhe në këtë pikë, gjatë periudhës së afatizimit. Pas kalimit të këtij afati, banka mund të vendosë që t'i transferojë ato në portofolion tregtare. Portofolio ndahet në bazë të sektorit institucional të cilit i përket emetuesi. Këtu konsiderohen nën-ndarjet vetëm qeveria dhe ndërmarrjet, ndahen në financiare dhe jofinanciare.

### **135. Portofolio Tregtare**

Ky zë mbulon instrumentet e negociueshme, afatshkurtër dhe afatgjatë, kur ato janë fituar nga institucioni raportues me qëllim rishitje për shkak të fitimit afatshkurtër për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj dhe një maturim më të shkurtër se maturimi i mbetur i instrument. Këto instrumente mund të blihen nga rastet që shfaqen ose në tregun sekondar dhe mund të mbahen për rishitje. Të gjitha llojet janë të përfshira nën këtë kre: aksionet, letrat me vlerë afatshkurtër (p.sh. letrat komerciale, bonot e thesarit të lëshuara nga qeveria, institucionet financiare, institucionet jofinanciare dhe pjesa tjetër e botës), letrat me vlerë afatgjate (p.sh. obligacione). Portofoli ndahet në bazë të sektorit institucional të cilit i takon emetuesi. Vetëm sektori qeveritar dhe ndërmarrjet, që ndahen në financiare dhe jofinanciare, do të meren parasysh.

### 149. Kreditë bruto

Kreditë janë asete financiare që krijohen kur një kreditori i huazon fondet në mënyrë të drejtrëpërdrejtë një debitori dhe janë evidentuar nga dokumente të panegociueshme. Kjo kategori përfshin kreditë e dhëna për klientët përveç bankave komerciale dhe bankës qendrore. Në këtë zë banka raportuese duhet të raportojë shumën e plotë të të gjitha llojeve të kredive dhe të sigurojë një ndarje sipas sektorit institucional të cilit i takon përfituesi. Të gjitha kreditë duhet të raportohet në bazë bruto. Kreditë nuk përfshijnë letra me vlerë të negociueshme dhe as kërkesat e raportuar si pjesë e aseteve fikse (shih sektorin për letra me vlerë). Kreditë përfshijnë një sërë instrumentesh. Qeqe tregtare të cilat institucioni raportues i ka fituar në lidhje me zbritjen e kredive, kërkesat që rrjedhin nga kreditë e konsumatorëve, kreditë hipotekare me rindërtim të kapitalit ose

me amortizim dhe termi kredi që përfshin kreditë për investime për ndërmarrje dhe pretendimet e tjera të tilla si llogaritë dyshimta, bilancet në llogarinë rrjedhëse kundrejt institucioneve financiare përveç bankave komerciale. Pranimet nuk përfshihen mbasi ata duhet të raportohen nën zërin 183.

#### 149-1. Provizionet në kredi

Të gjitha zbritjet për rezerva të veçanta për humbjet e identifikuar për secilën kredi nën zërin 149 duhet të raportohen. Siç është rasti në raportimin e huave bruto, provizionet duhen të ndahen sipas sektorëve institucionale.

#### 150. Financimi qerasë

Kjo është një marrëveshje tregtare, ku qiradhënësi (banka), do të blejë një aset (pajisje, makina, software, etj) si i kërkohet nga qiramarrësi (klienti apo huamarrës). Huamarrësi do të përdorë asetin gjatë periudhës së qirasë dhe do t'i paguajnë bankës një sërë këstesh apo ratash. Banka do të mbulojë një pjesë të madhe ose të gjitha kostot e asetit plus fitojnë interes nga kestet e paguara nga huamarrësi. Në mënyrë që të trajtohet një financim qeraje, një marrëveshje tregtare duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme: (i) pronësia e asetit transferohet huamarrësit në fund të afatit të lizingut, (ii) afati i lizingut është për pjesën më të madhe të jetës ekonomike të asetit, edhe nëse titulli nuk transferohet, (iii) asetet e dhëna me lizing janë të një natyre të specializuar të tilla që vetëm qiramarrësi mund t'i përdorë ato pa u bërë modifikime të mëdha.

150-1. Provizionet (financimi qerasë) Të gjitha zbritjet për rezerva të veçanta për humbjet e identifikuar për çdo marrëveshje të veçantë të lizingut financiar të parapara në zërit 150 duhet të raportohen nën këtë zë.

#### 179. Asetet fikse

Ky kre përmban aktivat financiare, aktivat e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivat e qëndrueshme të patrupëzuara të institucionit raportues. Vlerat e aktivave të qëndrueshme (p.sh., tokë ndërtesa, makineri e pajisje, mobilie, automjete dhe asetete të ngjashme) do të raportohen në vlera neto, pra duke përfshirë amortizimin e akumuluar nga vitet e kaluara, zhvlerësimin nga viti aktual, si dhe shumat e rivlerësimit. Objektet në ndërtim e sipër do të përfshihen gjithashtu.

#### **171. Asetet financiare fikse**

Nën këtë zë raportohen asetet në ndërmarrjet e anëtarësuar, si dhe në të gjitha ndërmarrjet e lidhura nga interesi i pjesëmarrjes dhe aksionet e korporatave në ndërmarrje, përveç atyre që janë të anëtarësuar ose me pjesëmarrje në interes, kur këto aksione mbahen për një kohë të gjatë.

*Ndërmarrjet e anëtarësuar* janë ndërmarrje të cilat i kontrollon institucioni i raportimit, kontrollohen nga to ose formojnë një konsorcium me to. Kontrolli supozohet:

- kur rezulton nga posedimi i shumicës së të drejtës së votës në lidhje me numrin total të aksioneve në ndërmarrjen në fjalë;
- kur një partner/ortak ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë pjesën më të madhe të drejtorëve ose menaxherëve;
- kur një ortak ka të drejtë të kontrollit në bazë të rregullave dhe akteve nënligjore të ndërmarrjes në fjalë ose të marrëveshjeve të lidhura me të;
- kur, si pasojë e marrëveshjeve të lidhura me partnerë të tjerë në ndërmarrjen në fjalë, njëri ortak mban shumicën e të drejtave të votës mbi të gjitha aksionet ose të drejtat e ortakëve të tjerë;
- në rastet e kontrollit të përbashkët.

Në çdo rast, në mungesë të provës për të kundërtën, një partner konsiderohet të ketë de facto kontroll në një ndërmarrje nëse në mbledhjen e ardhëshme deri në të fundit dhe në mbledhjen e fundit të përgjithshme të ndërmarrjes, të drejtat e tij të votimit përfaqësuan shumicën e votave të aksioneve të përfaqësuar në këto takime.

*Ndërmarrje të tjera të lidhura nga interesi i pjesëmarrjes* janë konsideruar si ndërmarrje të tjera (përveç ndërmarrjeve të anëtarësuar):

- në të cilat institucioni raportues ka drejtpërdrejt interes në pjesëmarrje;
- në të cilin, me dijeni të organit drejtues të bankës komerciale, ka interes të drejtpërdrejtë në pjesëmarrje;
- në të cilin, me dijeni të bordit menaxhues të bankës komerciale, janë degë të ndërmarrjeve të përmendura në pikën më lart.

Konsiderohet interes në pjesëmarrje kur të drejtat e korporatës përfaqësojnë, direkt ose indirekt, një të dhjetën e kapitalit.

Vlerësimet e aseteve të këtij lloji duhet të bazohen në çmimet e tregut ose vlerat e vërteta. Asetet financiare fikse janë rigrupuar sipas tri kategorive:

- kredi;
- pjesëmarrje dhe
- të gjitha asetet e tjera financiare fikse.

### **173. Asetet materiale dhe jomateriale**

Asetet materiale përfshijnë tokën, ndërtesat, fabrikat, makineritë, pajisjet, mobiliet, automjetet dhe të drejtat e lizingut. Këto do të raportohen në vlera neto, pra duke përfshirë amortizimin e akumuluar nga vitet e kaluara, zhvlerësimi nga viti aktual, si dhe shumat e rivlerësimit. Asetete jomateriale fikse janë shpenzimet për kërkime dhe zhvillime, të drejtat ekskluzive/privilegjet, patentat, licencat, vullneti i mirë, dhe kështu me

radhë. Ky kre përfshihen edhe shpenzimet që lidhen me zhvillimet, inkorporimet apo ristrukturimet e ndërmarrjeve të cilat janë konsideruar si asete.

#### **174. Kapitali vetanak**

Aksionet dhe kapitalet e tjera përfshijnë të gjitha instrumentet dhe të dhënat e pranuar, pasi të jenë përmbushur kërkesat e të gjithë kreditorëve, kërkesat mbi vlerën e mbetur të një korporate. Pronësia e kapitalit evidentohet zakonisht nga aksionet, rezervat, pjesëmarrjet ose dokumente të ngjashme. Kjo kategori përfshin kapitalin neto të pronarit në gjysmë-korporatat, si dhe aksionet dhe kapitalin në korporata. Ajo gjithashtu përfshin aksionet e preferuara ose aksione që ofrojnë pjesëmarrje në vlerën e mbetur mbas shkrirjes së një ndërmarrje të inkorporuar.

Aksionet (shpesh quhen aksione të zakonshme) e një korporate e që mund të mbahen (gjerësisht) nga shumë investitorë dhe të mbahen nga më pak investitorë, të mbahen nga një familje e vetme, apo të mbahet vetëm nga një shoqëri ose një individ. Aksionet në një korporatë mund të jetë aktivisht ose jo-aktivisht të tregtueshme në një treg të shkëmbimit të letrave me vlerë, tregtohen në tregun përtej caktimit ose të mos tregtohen.

#### **183. Detyrimet e papaguara të konsumatorëve**

Përmban kërkesat e bankës raportuese për klientët që rezultojnë se nuk kanë arkëtuar qeqe të arkëtueshme. Kjo pikë përfaqëson kryesisht urdhërpagesat dhe faturat e pamaturuara. Përdoret duke pranuar urdhërpagesat e tërhequra nga konsumatorët për pagesat për palët e treta. Kjo kategori përfshin pranimet dhe garancitë, si dhe qeqet e arkëtueshme dhe qeqet e mbetura për pagesa (zotimet për pagesa).

#### **185. Asetet e tjera**

Ky zë është pjesa që mbetet kundrejt të gjitha shënimeve të mëparshme në anën e aseteve në bilancin e gjendjes. Ky zë përfshin: metale të çmuar, pasurive të patundshme për rishitje, taksat, kontributet shoqërore, të ardhurat e grumbulluara, pagesat shtyra dhe asetet e patrupëzuara jofikse. Këto lloj asetesh duhet të vlerësohen në bazë të çmimeve të tregut.

### **DETYRIMET**

#### **219. Bilancet nga bankat e tjera**

Në anën e detyrimit, bilancet nga bankat e tjera përfshijnë të gjitha depozitat dhe huazimet e marra nga bankat, duke përfshirë edhe Bankën Qendrore. Shuma e depozitave nga bankat është raportuar sipas llojit të tyre:

- Llogaritë rrjedhëse;

- Llogaritë e kursimeve;
- Depozita me afat;
- Huazime të tjera

### 211. Llogaritë rrjedhëse

Kjo kategori përfshin bilancet menjëherë të pagueshme në llogaritë bankare rrjedhëse të bankave të tjera komerciale, si dhe depozitat njëditore.

### 212. Llogaritë e kursimit

Llogaritë e kursimit përfshijnë nën-bilancet, që përfaqësojnë një llogari që klienti mban në një bankë me qëllim të grumbullimit të fondeve gjatë një periudhe kohore. Fondet e depozituara në një llogari kursimi mund të tërhiqen vetëm nga pronari i llogarisë ose një agjent i autorizuar, apo në porosinë e patransferueshme të pronarit. Llogaria mund të zotërohen nga një ose më shumë persona. Disa llogari kërkojnë që fondet të mbahen në depozitë për një gjatësi minimale të kohës, ndërsa të tjerët lejojnë qasje të pakufizuar në fonde.

### 213. Depozita me afat

Ky zë përbëhet nga të gjitha llojet e tjera të detyrimeve, me përjashtim të llogarive rrjedhëse dhe atyre të kursimit, që rezultojnë nga aktivitetet normale me bankat. Ky zë përmban detyrimet me afat të caktuar më shumë se një ditë pune ose për një periudhë të njoftimit më të gjatë se një ditë pune, CD të panegociueshme, kërkesat që rrjedhin nga mobilizimi dhe parapagimet (rishitjen e qeqeve tregtare, marrëveshjet e riblerjes, avancet me ose pa kolateral dhe mbitërheqjet në llogaritë rrjedhëse).

### 215. Huamarrje të tjera

Huazimet janë burime fondesh të marra nga bankat që kanë përcaktuar dispozitat dhe kushtet e ripagimit dhe të cilat nuk janë llogaritë rrjedhëse, as huamarrje me afat 24 orësh (brenda natës) as letrat me vlerë. Kjo kategori përfshin kreditë ndër-bankare, linjat e kreditit, dhe të ngjashme. Ky zë është homolog me kreun 128. Plasmane të tjera.

### 229. Borxhet ndaj klientëve

Nën këtë pozicion shumat e borxheve ndaj klientëve (ku me klient nënkuptohen të gjithë personat e tjerë përveç Bankës Qendrore dhe bankave komerciale) raportohen sipas llojit:

- depozita; dhe
- huamarrje të tjera.

Depozitat ndahen më pas sipas sektorit institucional të cilit i përket depozituesi.

## 221. Depozitat

Përfshijnë të gjitha llojet e depozitave të tilla si llogari rrjedhëse, llogaritë e kursimit dhe depozitat me afat me përjashtim të CD-ve( çetifikatat) të panegociueshme.

## 223. Huamarrje të tjera

Ky zë përfshin shumën e të gjitha huave dhe CD-ve të panegociueshme nga institucione financiare jobankare dhe duke përjashtuar gjithashtu depozitat. Përfshin gjithashtu pozitën e portofolit të letrave me vlerë të negociueshme, llogaritë pezull, shumat e marra si mbulim për kredi dokumentare, depozitat të cilat kanë ardhur deri te maturimi dhe nuk janë rinovuar.

## 239. Borxhi i emetuar

Ky zë përmban shumën, me vlerë nominale, të letrave me vlerë të emetuara nga banka e raportuese.

Shuma është ndarë në bazë të kategorive të përgjithshëm të letrave me vlerë:

- CD-të e negociueshme të lëshuar nga banka për të cilën ka një treg sekondar të organizuar;
- Bankënotat që janë letra me vlerë të borxhit, me afat të shkurtër dhe të gjatë, të lëshuar nga banka;
- Bonot që janë letra me vlerë të borxhit afatgjatë të emetuara në raste të caktuara, me një periudhë të kufizuar për abonim nga banka.

Ndarja brenda/e jashtë vendit është e bazuar vetëm në informatat që banka ka në dispozicion në kohën e çështjes.

## 249. Zbritjet, provizionet

Shumat e zbritura shtohen në llogari për të mbuluar rrezikun e humbjes nga kërkesat në një të ardhme të pasigurt të cilat janë shënuar nën pozicionet 129, 139, 149, dhe 150 në anën e aseteve të bilancit të gjendjes që nuk ka dallim në mes rrezikut komercial të vlerësuar apo jo në baza individuale.

Provizionet përfshihen në forma të ndryshme. Provizionet për pension, pagesat fiskale, angazhimet e kreditit, pozicionimi në monedha të huaja. Ky kre përfshin gjithashtu edhe tatimet e shtyra dhe fondet e paparashikuara për rrezik. Marreveshjet e fundit me provizionet të cilat institucioni ka krijuar për të ruajtur aftësinë paguese të institucionit raportues ndaj rreziqeve në të ardhmen të cilat ende nuk janë të njohura. Në praktikë një pjesë e këtyre fondeve janë të njohura si "Fondi për rreziqet bankare të përgjithshme".



### 259. Detyrimet e tjera

Ky zë përfshin pjesën e mbetur të detyrimeve që nuk janë specifikuar diku tjetër në bilancin e gjendjes. Ato mund të jenë, taksa, paga dhe rroga dhe detyrimet shoqërore, dividendet dhe llogari të tjera të pagueshme, pagesat e mbledhura dhe të ardhura të shtyra (nga të cilat diferenca e vlerësimit të bilancit pozitiv).

### 269. Borxhi i ndërvarur dhe obligacionet

Ky zë përfshin vlerën e bankënotave të varuara ose obligacionit të shoqërisë aksionare në formë të borxhit të emetuara nga banka raportuese. Ky zë kryesisht përfshin instrumentet të cilat nuk janë përshkruar në pikën 219 deri 259. Kryesisht quhen borxhe të larta dhe janë borxhe të pasigurta dhe prioritet më të ulët e cili ndryshon nga depozita dhe instrumentet e letrave me vlerë. Borxhet e ndërvarura nënkuptojnë kërkesat e kreditorëve në asete dhe të ardhura. Ky artikull zakonisht është me maturim afatgjatë dhe ka rrezik dhe fitim më të lartë.

### 279. Obligimet e bankave në borxhin e papaguar

Përmban obligimet e bankës në premtimet për të paguar (acceptances) para skadimit të afatit të kontratës.

### 289. Burimet vetjake

Ky kre përbëhet nga:

- Kapitali aksionar;
- Rezerva kontingjente (për raste të paparashikuara);
- Rezerva të përgjithshme dhe rezerva të tjera;
- Fitimi / humbja vjetore;
- Fitimi / humbjete pa shpërndara.

### **281. Kapitali aksionar**

Totali i kapitalit të paguar për aksionet e emetuara të zakonshme dhe të preferuar, duke përfshirë një shtesë (premium), nëse ka marrë në kohën e lëshimit të aksioneve (shtesa barazon diferencën midis çmimit të realizuar gjatë shitjes dhe vlerën nominale të aksionit). Ky zë duhet të vlerësohet sipas vlerës së librave (kontabël). Që do të thotë, të vlerësohet nga fillimi si shuma nominale e të ardhurave dhe çdo emetim i mëtejshëm i aksioneve të pronarit.

### 283. Rezervë në rast të papriturash

Kjo është një rezervë e posaçme për të siguruar mbrojtje shtesë, nga efektet e humbjeve që mund të rezultojnë nga aktivitetet specifike të korporatës ose thujse-korporatës.

### 284. Rezervat e përgjithshme dhe të tjera

Këto janë përvetësime të fitimeve të mbajtura (të pashpërndara) dhe përfshijnë instrumentet financiare të kapitalit (ekuitit) që nuk janë derivat i fitimit në të hyrat e bankës, por ndikojnë direkt në kapitalin e pronarit, me rritje ose ulje të vlerës së kapitalit në rastin e investimit të këtyre instrumenteve. Mund të kërkohej me ligj të sigurohen njësia ekonomike dhe kreditorët e tyre me një mbrojtje shtesë nga efektet e humbjeve. Rezervat e përgjithshme dhe të tjera duhet të vlerësohen dhe regjistrohen si shuma nominale në kohën e investimeve dhe muajit përkatës dhe diferenca e fitimit apo humbjes është çështje e fitimit në të ardhura që paraqitet veçmas në fitimin ose humbjen vjetore për rezerva të tilla.

### 285. Fitimi / humbja vjetore

Fitimi / humbja e vitit përfshin shumën e rezultatit financiar të operacioneve të vitit aktual.

### 286. Fitimi / humbja e pashpërndarë

Raportohen shumat e fitimit apo humbjes neto të realizuar gjatë viteve të mëparshme për të cilat nuk është caktuar alokimi përfundimtar nga kontabëliteti i bankës. Humbjet/fitimi i mbajtur (pashpërndara) duhet të vlerësohen si shuma nominale e të ardhurave që janë mbajtur.

#### Zëra shtesë:

#### 287. Eksporti i parasë fizike

Kjo kategori përfshin shumën e parave fizike eksportuar nga vetë banka për muaj të caktuar (nevojiten të dhënat jokumulative për çdo muaj). Eksporti i të hollave duhet të raportohet veçmas për paratë në euro dhe ato jo-euro, konvertimi në euro bëhet në bazë të kursit të këmbimit të ofruara nga BQK-ja në fund të muajit. Kjo kategori përfshin vetëm eksportet e drejtpërdrejta të parasë fizike jashtë shtetit, dhe nuk duhet të përfshijnë paratë e eksportuara jashtë vendit nëpërmjet ndonjë institucioni ndërmjetës (p.sh. nëse banka A eksporton para fizike jashtë vendit përmes bankës B në vlerë prej 10 milionë euro, atëherë kjo shumë duhet të raportohet si para e eksportuar vetëm nga banka B, dhe të mos raportohet nga banka A). Gjithashtu paratë e gatshme të eksportuara në BQK nuk duhet të trajtohen si para të eksportuara.

### 288. Importi i parasë fizike

Kjo kategori përfshin shumën e parave fizike të importuara nga banka vetëm për një muaj të veçantë (të dhënat jokumulative mujore të aktivitetit). Importi i të hollave duhet të raportohet veçmas për euro dhe jo-euro, konvertimi në euro bëhet në bazë të kursit të këmbimit të ofruara nga BQK-ja në fund të muajit. Kjo kategori përfshin vetëm importin e drejtpërdrejtë të parasë fizike nga jashtë, dhe nuk duhet të përfshijë paranë e importuar nëpërmjet ndonjë institucioni ndërmjetësues (p.sh. nëse një bankë A importon para fizike nga jashtë nëpërmjet bankës B në vlerë prej 15 milionë euro, atëherë kjo shumë duhet të raportohet si import vetëm nga banka B, dhe jo të raportohet nga banka A). Gjithashtu para të gatshme të importuara nga BQK nuk duhet të trajtohen si import.

## 2.2. Kreditë sipas aktivitetit ekonomik (Formulari BS / LBI)

### A. Udhëzime të përgjithshme

Tabela përmban vlerën kontabel të të gjitha kredive, të shprehura në euro dhe në valuta të tjera, sipas kategorisë së industrisë. Të gjitha huatë dhe shtimet e kredive duhet të raportohen në baza bruto. Kredi me afat do të thotë çdo lloj kredie, si kredi tregtare, kredi hipotekare, kredi konsumatore, linjë kredie, kredi pranimi, kërkesat e bazuara në garancitë e paguara dhe instrumente të tjera si garanci etj, duke përjashtuar llogaritë e arkëtueshme. Në këtë formularë shumat do të raportohen sipas maturimit origjinal.

### B. Udhëzime të detajuara sipas rreshtave

Ndarja e kredive sipas aktivitetit ekonomik bazohet në klasifikimin e NACE (Shtojca 3: Klasifikimi NACE- nga frangjishtja Nomenclature Generale des Activites Economiques dans l'Union Europeenn, në Shqip – Emërtimi gjeneral i aktiviteteve ekonomike në Bashkimin Evropian). Ndarja e kredive sipas kategorive ekonomike është paraqitur si më poshtë:

**Bujqësia** - përfshin kreditë me qëllim të financimit të aktiviteteve bujqësore .

**Industria, energjia dhe ndërtimaria** - përfshin kreditë të llojeve të listuara më poshtë:

- Aktivitetet e minierave dhe guroreve;
- Prodhimin;
- Produktet e energjisë, gazit, dhe naftës;
- Industrinë e ujit dhe aktiviteteve të tjera të ndërlidhura me ujin.
- Ndërtimin.

**Shërbimet** - përfshijnë shërbime si më poshtë:

- Tregti (me shumicë dhe pakicë);
- Transporti dhe magazinimi;
- Akomodimi dhe shërbime të tjera (akomodimet në hotele, motele, shërbim i ushqimit dhe pijeve në restorante);
- Informacioni dhe komunikimi (veprimtari botuese, transmetime në TV dhe radio,

prodhimet dhe programet, telekomunikacioni, etj);

- Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (aktivitetet financiare, pensionet dhe fondet dhe aktivitetet sociale financiare, aktivitetet e sigurimit);

- Pasuria e patundshme dhe qiraja;

- Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike (aktivitetet ligjore dhe të kontabilitetit, arkitektura, inxhinieria dhe hulumtimet shkencore, etj);

- Aktivitetet publike, shoqërore dhe administrative (aktivitetet e shërbimeve administrative, administrimi publik, dhe ruajtja e sigurisë shoqërore, edukimi, etj);

- Aktivitete të shërbimeve të tjera (aktivitete të anëtarësimit në shoqatë dhe shërbime të tjera personale).

### 2.3. Përbërja e portofolios së letrave me vlerë (*Formuari BS/SPC*)

#### A. Udhëzime të përgjithshme

Kjo tabelë përfshin ndarjen e portofolit të letrave me vlerë për llogari të institucionit raportues. Dallimi në mes të investimit dhe tregtimit, siç ishte rasti në bilancin e gjendjes duhet mbajtur ndaras. Portofolio e investimeve përplotësohet me letrat me vlerë të rezervuar si asete financiare fikse. Letrat me vlerë duhet të ndahen më tej sipas llojit - e njëjta strukturë ruhet për portofolin e investimeve dhe tregtisë - dhe sipas sektorëve institucionalë të emetuesit, sipas strukturës të paraqitura në Shtojcën 2. Shumat e raportuara janë ato të mbajtura në bilancin e gjendjes për t'u tregtuar në vlerë të tregut. I njëjti parim vlen edhe për vlerësimin e portofolit të investimeve dhe asetëve fikse financiare, por mund të lejohen edhe skema të tjera të vlerësimit. Pjesa në portofolin e investimeve dhe asetëve financiare fikse i referohet të dhënave në pikat 132 dhe 171 në bilancin e gjendjes (pjesëmarrjet dhe aksionet e tjera, asetet e tjera financiare fikse). Pjesa në portofolin e tregtimit i referohet pikës 135 të bilancit të gjendjes.

#### B. Udhëzime të detajuara sipas rreshtave

Obligacionet janë letra me vlerë afatgjate dhe raportohen duke bërë një dallim në mes të (i) obligacioneve me normë interesi fikse gjatë gjithë maturimit të obligacionit, dhe (ii) obligacioneve me normë lëvizese, për të cilat norma ndryshon kohë pas kohe, ku ndryshon norma e interesit fiks nga nën periudha e deklaruar, ose një normë interesi e cila është e rregulluar kohë pas kohe për zhvillimin e një norme interesi referuese. Obligacionet e ndërvarura, për të cilat mbajtësi do të jetë në vartësi të kreditorëve të tjerë jopreferencialë të emetuesit. Për të kompensuar këtë rrezik atribuohet një normë e lartë interesi. Letra komerciale është një letër me vlerë e lëshuar në kuadrin e programeve të letrës komerciale ndaj njësive institucionale, kryesisht jo ndaj institucioneve kredituese. Ata janë zakonisht letra me vlerë afatshkurtër. Certifikatat janë letra me vlerë afatshkurtër zakonisht të lëshuara nga agjencitë qeveritare apo institucionet kredituese.

## 2.4. Kreditë sipas afateve (Formulari BS / LBM)

### A. Udhëzime të përgjithshme

Tabela paraqet totalin e kredive të garantuara kunderpartëve ( klientëve), të ndarë sipas sektorëve institucionalë (sektori i brendshëm, sektorin e jashtëm të ndarë në banka dhe jobanka dhe UNMIK / EULEX) dhe sipas maturimit. Kjo tabelë paraqet maturimin e mbetur, i cili duhet të sigurohet për totalin e të gjitha kredive dhe ndahet në pjesë kohore. Maturimi origjinal, gjithashtu i ndarë në kohë, kërkohet veçmas për kreditë bruto të siguruara, kreditë bruto të pasiguruara dhe balancat me bankat.

Brenda pjesës së maturimit origjinal BQK dhe bankat komerciale janë të përjashtuara për nënndarje të kredive të siguruara dhe të pasiguruara, dhe financimit me lizing, pasi ato janë vetëm kunderpart i nënndarjes mbi depozitat dhe plasmanet me bankat. Kjo do të thotë se të dhënat në pjesën mbi maturimin origjinal i referohen bilancit të gjëndjes 149, 150, dhe 171 partim (kredi për institucionet jobankare), përkatësisht zërat e bilancit të gjëndjes 115, 129, dhe 171 (kredi në banka). Brenda pjesës për maturimin e mbetur BQK-ja dhe bankat komerciale nuk trajtohen veç e veç dhe formojnë një pjesë integrale të kunderpartëve që raportohen. Si pasojë, të dhënat në këtë pjesë i referohen zërave të bilancit të gjëndjes 115, 129, 149, 150, dhe 171 (kreditë). Tabela duhet të dërgohet për kredi në euro dhe kredi në valuta të tjera, të konvertuara në euro.

### B. Udhëzime të detajuara sipas rreshtave

Kreditë sipas maturimit për qëllime të RSB-së janë ndarë në kredi bruto të siguruara dhe kredi bruto të pasigurta. Një kredi e siguar është një kredi në të cilat huamarrësi lë peng një pasuri (p.sh. një makinë, shtëpi, ose pronë tjetër), si kolateral për kredinë e huazuar. Kështu, borxhi është siguar në saje të pasurisë së lënë peng, për mosplotësim të mundshme të huamarrjes. Në rast të tillë, kreditori merr në dorëzim pasurinë e lënë si kolateral dhe mund ta shesë atë për të përmbushur borxhin duke rifituar kështu shumën e huazuar fillimisht për huamarrësin. Në përgjithësi, kreditë e siguruara janë ato kredi që kanë kolateral. E kundërta e kredive të siguruara janë kreditë e pasiguruara, që nuk janë të lidhura me ndonjë peng të veçantë.

## 2.5. Depozitat sipas afateve (Formulari BS/DBM)

### A. Udhëzime të përgjithshme

Tabela paraqet totalin e depozitave të pranuar nga nga kunderpartet sipas sektorëve institucionalë që ata u përkasin (sektori i brendshëm, sektorin e jashtëm i ndarë në banka dhe institucione jo-banka dhe UNMIK / EULEX si sektor i veçantë) dhe sipas maturitetit atij origjinal (fillestar dhe të mbetur).

Të dhënat për t'u raportuar në secilin nga këto nën pjesë u referohen respektivisht zërave të bilancit të gjëndjes 211 dhe 221 (llogari rrjedhëse), zërat 212, 213 dhe 221

(depozita përveç llogarisë rrjedhëse), dhe më në fund zërave 215 dhe 223. Kreditë / depozitat e ndëvarura dhe të lëshuara nga banka raportuese, të raportuara në bilancin e gjëndjes 269 me konventë, duhet të raportohen në nën pjesën që ka të bëjë me huazimet e tjera. Në maturimin e mbetur shuma e të gjitha depozitave dhe huazimeve merret në konsideratë. Me këtë, të dhënat në këtë pjesë i referohen zërave të bilancit të gjëndjes 219 dhe 229, edhe me konventë bilancit të gjëndjes 269. Tabela duhet të dërgohet për depozitat në euro dhe depozitat në valuta të tjera, të konvertuara në euro.

## **B. Udhëzime të detajuara sipas rreshtave**

Depozitat sipas maturimit ndahen në llogari rrjedhëse, llogari të kursimit, depozita me afat dhe huazime të tjera. Llogaritë rrjedhëse përfshijnë shumën e depozitave të përgjithshme nga të gjithë sektorët që janë menjëherë të arkëtueshme pa ndonjë dënim ose të ngjashme. Depozitat e kursimit përfaqësojnë paratë e depozituara në një bankë për përdorim jo të menjëhershëm dhe banka paguan interes depozitat e kursimit. Në shumicën e rasteve, depozitat e kursimit mund të tërhiqen në çdo kohë duke përlogaritur interesin deri në datën kur paratë janë tërhequr nga depozitat e kursimit. Depozitat me afat janë depozita me afat të përcaktuar që nuk mund të tërhiqet para periudhës kohore të rënë dakord në mes klientit dhe bankës. Në to përfshihen depozitat me afat dhe certifikatat e panegociueshme të depozitave. Kjo, përfshin shumën e të gjitha huazimeve (nga bankat dhe jobankat) me përjashtim të atyre rrjedhëse, të kursimit dhe depozitave me afat.

## **2.6. Borxhi i lëshuar nga banka (Formulari BS/DS)**

### **A. Udhëzime të përgjithshme**

Kjo tabelë përfaqëson borxhin e emetuar nga banka dhe klasifikuar nga kunderparti sipas sektorëve institucionalë të cilëve u përket (sektori i brendshëm, sektori i jashtëm të ndarë në banka dhe jobanka dhe të tjera) dhe sipas maturimit. Tabela BS / DS përfshin tabelat për raportimin e borxhit të letrave me vlerë të emetuara nga banka përkatëse në euro dhe jo euro, por të konvertuar në euro. Të dhënat të cilat duhet të raportohen në këto nënpjesë u referohen (duhet të përputhen) me vlerën nominale të artikujve të bilancit të gjëndjes 239.

### **B. Udhëzime të detajuara sipas rreshtave**

Letrat me vlerë të borxhit ndahen nga lloje kryesore të letrave me vlerë (i) CD të negociueshme, (ii) Dëftesa, dhe (iii) Obligacionet. CD-të e negociueshme janë letrave me vlerë të lëshuara nga një bankë dhe që ndryshe nga depozitat me afat, janë të negociueshme gjatë jetëgjatësisë së certifikatës. Shënime janë një lloj instrumenti financiar shumë të ngjashme me certifikatën e depozitave, por në parim janë të panegociueshme. Obligacionet janë instrumente financiare afatgjata (3 deri 5 vjet), të lëshuar nga banka. Ato janë të negociueshme në parim. Janë të krahasueshme me CD-të e negociueshme, me përjashtim të maturimit të tyre fillestare. Ato mbajnë një normë interesi fikse ose të ndryshueshme dhe mund të jenë të nënvarura (në këtë rast ata do të mbajnë një normë interesi më të lartë sesa një në obligacionet jo të varura, për shkak të rrezikut të lartë).

### 3. REGULLAT E VALIDIMIT

Rregullat e validimit janë një instrument i kontrollit të sasisë dhe cilësisë së të dhënave. Janë rregulla të cilat përfshijnë validimin e tabelave të vetme (rregullat brenda tabelave), por edhe validimin në mes të tabelave të ndryshme (rregullat ndërmjet planeve), qoftë në të njëjtën periudhë të referencës apo midis periudhave të ndryshme referuese.

Rregullat e validimit mund të marrin forma të ndryshme: *algjebrike*, *logjike* dhe të *kushtëzuar*. Në fazën e parë rregullat e vlefshmërisë do të përqendrohen në rregulla algjebrike. Kjo do të thotë se ata do të pranohen vetëm nëse përmbushin një formulë algjebrike. Një shembull i thjeshtë është se elemente të një shumë të përgjithshme duhet ti shtohen asaj shume. Rregullat e hollësishme të validimit të përfshira në Udhëzimet e Raportimit, janë paraqitur në Shtojcën 1.

### 4. FORMULARËT E RAPORTIMIT

Raporti Statistikor Bankar përbëhet nga një faqe ballinë dhe master planet, nga të cilat BS / LBM dhe BS / DBM ndahen në funksion të monedhës së kredive përkatësisht depozitave duke bërë që numri i përgjithshëm i planeve të jetë tetë, të tilla si:

- **Faqe hyrese;**
- **Bilanci i gjendjes (BS):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;
- **Kredi sipas industrisë (BS / LBI):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;
- **Përbërja e portofolit të letrave me vlerë (BS / SPC):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;
- **Kredi sipas maturitetit (BS / LBM):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;
- **Depozitat sipas maturitetit (BS / DBM):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;
- **Letrat me vlerë të borxhit (BS / DS):** Euro dhe jo-euro konvertuar në euro;

Faqen e parë (hyrëse) duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga personi(at) e autorizuar. Dorëzimi i parë elektronike për një muaj të caktuar duhet të përmbajë të gjitha të tabelat. Çdo tabelë RSB-së identifikohet nga një sërë informacionesh:

- Emri i bankës raportuese ('Emri i Bankës');
- 'Kodi i valutës' që shpjegon përbërjen e valutës së të dhënave të raportuara në plan:
  - Vetëm euro (kodi 1);
  - Valuta me përjashtim të euro, por të konvertuara në euro për shkak raportimi (kodi 3);
  - Euro e kombinuar me valuta të tjera jo euro por të konvertuara në euro për shkak raportimi (kodi 5);
- Kodi i 'Muajit Referues' i të dhënave në raport (VV/MM);
- 'Data e Raportimit' tregon datën në të cilën është dërguar raporti (VV/MM/DD).



# RAPORTI STATISTIKOR BANKAR

(Versioni 2.0)

Emri i bankës

Dita e periudhës raportuese dhe numri i raportimit

Shënim: Raporti Statistikor Bankar duhet të nënshkruhet nga nëpunësi përgjegjës i bankës që e përgatitë atë dhe së paku nga një anëtarë i bordit menaxhues të institucionit përkatës.

Të plotësohet nga banka:

Në cilësinë e nëpunësit të autorizuar apo të anëtarit të bordit menaxhues të bankës, deklaroj se Raporti Statistikor Bankar është

Nënshkrimi i nëpunësit përgjegjës

Nënshkrimi i anëtarit të bordit menaxhues

Data e raportimit të drafrit të parë

Data e konfirmimit

Të plotësohet nga BQK:

Aprovimi nga Statisticienti

